



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Komuna e Prishtinës
Pristina Obstina-Municipality of Pristina



SEKTORI I PROKURIMIT - KABINETI I KRYETARIT

Bazuar në nenin 108/A paragrafi 10 nënparagrafi 10.2 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik lidhur me nenin 60 të Ligjit nr. 05/L-068 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin nr. 04/L-237 dhe me ligjin nr. 05/L-092, si dhe duke u bazuar në nenin 61 paragrafi 61.3. lidhur me nenin 63 paragrafin 63.1 nënparagrafin 63.1.1. pikën a) si dhe lidhur me nenin 62 paragrafin 1 nënparagrafin d) të Rregullores (A01) nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, duke vendosur sipas kërkesës për rishqyrtim të operatorit ekonomik "Engrup" Sh.P.K. të datës 31.05.2023 kundër njoftimit mbi vendimin e datës 26.05.2023 të autoritetit kontraktues lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Vazhdimi i punimeve në shkollën Nënë Tereza - Ritender" me nr. të prokurimit 616-23-3871-5-2-1, Komuna e Prishtinës (autoriteti kontraktues) përmes zyrtarit përgjegjës të prokurimit nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. **REFUZOHET** kërkesa për rishqyrtim e operatorit ekonomik "Engrup" Sh.P.K. dt. 31.05.2023 kundër njoftimit mbi vendimin dt. 26.05.2023 të autoritetit kontraktues për aktivitetin e prokurimit me titull "Vazhdimi i punimeve në shkollën Nënë Tereza - Ritender" me nr. të prokurimit 616-23-3871-5-2-1.
- II. **AUTORIZOHET** autoriteti kontraktues - Komuna e Prishtinës që të vazhdoj me aktivitetin e prokurimit të përcaktuar në pikën I të këtij vendimi.
- III. **NJOFTOHET** operatori ekonomik "Engrup" Sh.P.K. si dhe të gjitha palët tjera të interesuara lidhur me këtë vendim përmes publikimit në platformën elektronike E-Prokurimi në adresën <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Arsyetim

Operatori ekonomik "Engrup" Sh.P.K. (tutje "parashtruesi) me datë 31.05.2023 ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim kundër njoftimit mbi vendimin e datës 26.05.2023 të autoritetit kontraktues lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Vazhdimi i punimeve në shkollën Nënë Tereza - Ritender" me nr. të prokurimit 616-23-3871-5-2-1. Gjatë shqyrtimit paraprak të kërkesës për rishqyrtim të parashtruesit është gjetur se kërkesa është e lejuar dhe është parashtruar brenda afatit nga personi i autorizuar dhe nuk ekzistojnë pengesa tjera për të shqyrtuar kërkesën e parashtruesit. Prandaj janë plotësuar kushtet për shqyrtimin meritor (*in meritum*) të kërkesës.

Pretendimi i parashtruesit është cituar si në vijim: *“Duam te ju sqarojme se pasi qe ky aktivitet i prokurimit eshte shpallur disa here nga autoriteti kontraktues dhe poashtu anuluar heren e fundit, neve i kemi patur dy sigurime te tenderit dhe ne vend qe ta ngarkojme sigurimin e ri te tenderit gabimisht e kemi ngarkuar sigurimin e vjeter perderisa i posedojme te dy sigurimet me afat valid ende”*.

Parashtruesi nuk ka potencuar cilat dispozita të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik (tutje “LPP”). Autoriteti Kontraktues – Komuna e Prishtinës përmes zyrtarit përgjegjës të prokurimit me datë 01.06.2023 ka trajtuar kërkesën e parashtruesit për rishqyrtim.

Lidhur me pretendimin e parashtruesit fillimisht duhet theksuar që parashtruesi nuk e konteston fare arsyen për të cilën është eliminuar nga aktiviteti i prokurimit. I njëjti në kuadër të pretendimit të tij, në mënyrë paradoksale konfirmon që *“ne vend qe ta ngarkojme sigurimin e ri te tenderit gabimisht e kemi ngarkuar sigurimin e vjeter”*. Në anën tjetër nga administrimi i dosjes së tenderit është gjetur se sigurimi i tenderit është një nga kërkesat e përcaktuara lidhur me këtë aktivitet të prokurimit. Komisioni vlerësues në këtë rast ka gjetur se parashtruesi nuk ka dorëzuar sigurimin e tenderit për aktivitetin e prokurimit për të cilin ka ofertuar. Duke marrë parasysh që ky fakt nuk kontestohet as nga vet parashtruesi është gjetur se pretendimi i tij është i pabazuar dhe kundërthënës.


Sipas trajtimit dhe elaborimeve më lartë në këtë vendim është gjetur se parashtruesi nuk ka paraqitur argumente të qëndrueshme për të mbështetur pretendimin e tij. Njëkohësisht nga provat materiale të administruara është gjetur se pretendimi i parashtruesit është tërësisht i pabazuar. Prandaj kërkesa për rishqyrtim e parashtruesit është refuzuar si e pabazuar në tërësi.


Për pikën I dhe II të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 par. 63.1.1. nënparagrafin a) lidhur me nenin 62 par. 62.1. nënparagrafin d) të Rregullores nr. 001/2022 për Prokurimin Publik.

Për pikën III dhe IV të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 par. 63.2. të Rregullores nr. 001/2022 për Prokurimin Publik.

Bazuar në të thënat më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Prishtinë, 01.06.2023


Ud. Udhëheqës i Sektorit të Prokurimit
Komuna e Prishtinës



Këshillë juridike:

Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të paraqes ankesë pranë Organit Shqyrtues të Prokurimit brenda afatit prej dhjetë (10) ditëve pas pranimit të këtij vendimi.

Faqe 2 nga 2